



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA ARSIMORE**

RELACION

PËR MIRATIMIN E FUNKSIONIMIT TË GRUPEVE ME 5-10 NXËNËS, NË NJESITË ADMINISTRATIVE, PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” pika 12. “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe”.

Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhërin nr 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”

Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”

Po paraqesim për miratim funksionimin e grupeve me 5-10 nxënës, në 18 kopshtet e 4 njësive administrative, për vitin shkollor 2025-2026.

Duke u mbështetur në Udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar” pika I/ 1.c ku citohet:

Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë, në rast kur ky numër nuk sigurohet, mund të formohet një grup jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë kopshtet, pas mendimit pozitiv të njësive të vetëqeverisjes vendore

Si dhe në faktin që në 18 kopshte të njësive administrative rezulton frekuentim si më poshtë:

Nr	Njësia administrative		Kopshti	Nr i fëmijëve
1	Roshnik	1	Roshnik	6
		2	Karkanjoz	7

		3	Vojnik	5
		4	Paftal	6
2	Sinjë	5	Mbjeshovë	9
		6	Molisht	7
		7	Gjoroven	5
		8	Veleshnje	7
		9	Drobonik	7
3	Velabisht	10	Bilçë 1	7
		11	Bilçë 2	5
		12	Orizaj	5
		13	Ullinjas	9
		14	Lapardha 2	9
		15	Lapardha Qendër	10
		16	Lapardha Qoshk	10
4	Otllak	17	Moravë Hatillarë	5
		18	Moravë Stan	7
	Totali	18		126

Për vitin shkollor 2025-2026, për shkak të numrit të ulët të regjistrimeve në kopshte, mbyllen dy grupe fëmijësh: Bogdan dhe Rëmanicë.

Për vitin shkollor 2025-2026, për shkak të numrit të lartë të regjistrimeve, hapet një grup i ri në kopshtin “Velabisht”.

Mësuesja e grupit të kopshtit “Bogdan”, emërohet në kopshtin “Velabisht”

Mësuesja e grupit të kopshtit “Rëmanicë”, kalon për nevojat e drejtorisë si mësuese ndihmëse në kopshtin “Çlirim 1”

Kërkojmë nga ana juaj miratimin e funksionimit të këtyre grupeve me 5-10 nxënës, në 18 kopshtet e 4 njësive administrative.

DREJTOR

Klodiana Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHETIT TË MBROJTJES CIVILE

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1 gërma b, pika 5 , VKM nr.1153 datë 24.12.2020 “Për Miratimin e Uniformës, Shenjave Dalluese Përkatëse, Flamurit dhe Stëmës së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr. 2126/1 prot datë 19.02.2025” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2025” ku Bashkisë Berat i është akorduar fondi në shumën 11,521,812.34 lekë.

Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 49, datë 26.06.2025, “Mbi Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit të Mbrojtjes Civile”, nga Kodi Produktit 91707AG me vlerë 9,500,000 lekë, ka miratuar për përdorim një shumë prej 9,296,824.10 lekë për realizimin e masave në fushën e mbrojtjes civile”

Nga procesi i prokurimit, i zhvilluar për këtë qëllim është realizuar kontraktimi dhe ekzekutimi i fondeve në vlerën **6,977,011.12 lekë**, duke sjellë një kursim buxhetor prej **2,522,988.88 lekë** nga totali i fondit të akorduar për këtë qëllim.

Bazuar në:

- Verifikimet në terren të kryera nga strukturat teknike të bashkisë,
- Kërkesat e përsëritura të komunitetit dhe njërive administrative për ndërhyrje në zona me rrezikshmëri të lartë,
- Gjendjen e mureve mbajtëse të dëmtuara, terreneve të paqëndrueshme dhe nevojës për pajisje të domosdoshme për emergjenca,
- Kërkesat e dërguara nga drejtoria e MZSH për blerje komplete uniformash zjarrduruese, propozohet që fondi i kursyer të rialokohet për:

1. Ndërhyrje në zonat me risk të lartë, për forcimin e strukturave mbrojtëse dhe stabilizimin e terreneve që paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve;
2. Blerjen e komplete uniforma zjarrduruese që do të përdoren nga strukturat përgjegjëse për reagim në raste fatkeqësish natyrore apo situata të paparashikuara.

Ky rialokim është në përputhje të plotë me qëllimin dhe objektivat e fondit të Mbrojtjes Civile, si dhe me prioritetet e Bashkisë Berat për garantimin e sigurisë së komunitetit. Për sa më sipër, paraqitet për miratim nga Këshilli Bashkiak nga shuma e kursyer prej 2,354,267.60 lekë për qëllimet e përmendura më lart për:

- Lagjia “Muzakaj”, Rajoni Nr.1 kemi mungesë të mureve mbajtës në këtë segment duke rrezikuar stabilitetin dhe integritetin strukturor të objekteve të banimit dhe trupit të rrugës vlera: 1,154,267.6 lekë me tvsh, l=27 ml.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

- Blerjen e tetë complete uniformash zjarrrdurese për personelin operues zjarrfikës me vlerë 1,200,000 lekë me tvsh.

Bashkëngjitur do të gjeni dokumentacionin teknik.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË I KOMANDUAR

Ervin CECA

Drejtorja e Planifikimit Urban Erida Nasufi-drejtore 

Drejtorja e MCPTSH Sokol Toska-Drejtore

Drejtorja e Menaxhimit Financiar Roven Shahu-drejtore 



BASHKIA BERAT

PREVENTIVI I PUNIMEVE

OBJEKTI: "NDERHYRJE REHABILITUESE NE MURET MBAJTES DHE TERRENE NE TERRITORIN E BASHKISE, NE KUADER TE MBROJTJES CIVILE"

FAZA:PROJEKT ZBATIMI

Ndertim mur guri mbajtes Lagja Muzakaj ,Rajoni nr 1 , L=27ml

Nr	Nr.an	Emërtimi i Punimeve	Njesi	Sasi	Cmimi	Vlera
		A - Punime muri mbajtës	L=	27.00	m	
1	3.89/a	Germim dheu me eksk. goma 0.25 m ³ , kanale b< 2 m, tokë zak,	m3	126.90	361.42	45,864.2
2	2.37/5a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	126.90	318.60	40,430.3
3	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm (poshte shtreses C 12/15)	m2	131.70	398.23	52,446.9
4	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (poshte themelit)	m3	3.92	13,305.11	52,089.5
5	3.323	Mur guri mbajtes e themele , llac cemento M 500	m3	48.60	7,335.81	356,520.4
6	3.287	F.V. hekur betoni i zakonshe m Ø 6 ~ 10mm	ton	0.15	155,046.18	23,020.2
7	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20(brezi betonit)	m3	13.50	13,938.36	188,167.9
8	3.653	F.V. tuba plastmasi Ø 150 (me vrima, drenazh pas mureve)	ml	27.00	786.54	21,236.6
9	3.654	F.V. tuba plastmasi Ø 100 (në mur, kullim ujra çdo 10m)	ml	21.60	498.91	10,776.5
10	3.48/b	Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zak.	m2	67.50	166.46	11,236.1
11	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	54.00	2,446.0	132,085.1
		Shuma A				933,873.5
		Fondi rezerve 3 %				28,016.2
		Shuma A+Fond rezerve				961,889.7
		Tvsh 20 %				192,377.9
		Shuma Totale				1,154,267.6

Preventivoi:

Ing.Valentina Karabina

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
Z. Ervin CECA





BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN Z.GABRIEL SADIK.**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **Ylvia Canko** me nr. 593 prot, datë 28.04.2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

I ndjeri **z. Gabriel Sadik**, prej vitesh i diagnostikur me Hemofili A,B dhe C, sëmundja Willebrand është djali i dytë i familjes Sadik që humb jetën nga e njëjta sëmundje. Djali prej lindjes është diagnostikuar me sëmundjen e rëndë e cila e ka kufizuar për integrimin e tij. Nëna e vetme, pas zgjidhjes së martesës, e cila trajtohej me pagesë për aftësinë e kufizuar pasi ka sëmundje pleksopatite dhe plineuropatite është kujdesur për rehabilitimin shëndetësor por që ka qënë e pamundur shërimi. Gabrieli kishte krijuar edhe familjen e tij, ku nga bashkëjetesa ka lindur edhe një fëmijë, i cili është ende i mitur. Për shkak të një traume të enëve të gjakut në gjymtyrët të poshtëm Gabrieli ka ndëruar jetë në muajin Prill 2025.



4

Pas vdekjes së tij, znj.Canko ndodhet përpara vështirësive ekonomike dhe sociale, pasi tashmë duhet të kujdeset edhe për familjen e djali, sidomos për fëmijën e mitur i cili kërkon kujdes për mirërritjen në plotësimin e nevojave bazike.

Bashkëjetuesia e z.Sadik aktualisht nuk mund të punoj pasi djali është ende shumë i mitur dhe kërkon kujdes për rritjen dhe zhvillimin.


Duke u bazuar në historikun e rastit dhe në vlerësimin social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit, kërkesës së paraqitur nga **znj.Ylvie Canko**, drejtorja e Shërbimit Social, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 62.000 (gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

- 1.Certifikatë familjare.
- 2.Certifikata e vdekjes.
3. Kërkesën nga znj.Ylvie Canko.
4. Vërtetim për aftësinë e kufizuar në Ylvije Canko.
- 5.Certifikate familjare e fëmijës.
6. Faturë tatimore nga subjekti funeral.
- 7.Korespondenca me Shërbimin Social.

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati





BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN Z.HALI KULE.**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **Gjergji Kule** me nr. 867 prot, datë 28.06.2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

I ndjeri z.Hali Kule, ishte i sistemuar në institucion të përkujdesjes së moshës së tretë në Polican nga strukturat e shërbimeve shoqerore pas kërkesës së djali i tij të vetëm Gjergji. Të dy jetonin në kushte shumë të vështira social-ekonomike, në një banesë të papërshtatëshme për të jetuar e cila nuk plotësonte nevojat bazike për një të moshuar. Djali ndihej i pamundur për tu kujdesur për të pasi ai vetë paraqet paqëndrueshmëri mendore/të sjelljes por është i pa diagnostikuar.

Gjergji, djali i të ndjerit, prej vitesh është identifikuar dhe mbështetur nga shërbimi social, si individë në nevojë duke e trajtuar me ndihmë ekonomike, duke e përfshirë në programet e punësimit nga AKPA dhe vazhdon përsëri të trajtohet me ndihmë ekonomike nga shërbimi social.



Gjatë vizitave në familje, nga strukturat e shërbimit social, është vlerësuar situatë e vështirë e jetesës që ai ka dhe pamundësia, pavarësia që atij i mungon për tu kujdesur për veten dhe ambjentin e banesës. Jeton në kushte jo të përshtatëshme jetese por që nuk arrin ta konceptoj këtë situatë.

Pas vdekjes së babait, z. Kule ndodhet edhe përpara vështirësive të tjera ekonomike dhe sociale, pasi duhej të përballoj edhe shpenzimet e varrimit por e ka të pamundur financiarisht.

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit, kërkesës së paraqitur nga **z. Gjergji Kule** drejtoria e Shërbimit Social, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

- 1.Certifikatë familjare.
- 2.Certifikata e vdekjes.
3. Kërkesën nga z.Gjergji Kule.
- 4.Certifikate familjare e fëmijës.
5. Faturë tatimore nga subjekti funeral.
- 6.Korëspodenca me Shërbimin Social.

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA ARSIMORE

RELACION

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË KURSEVE DHE NUMRIT TË INSTRUKTORËVE
TË JASHTËM NË QKF BERAT, PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 8 pika 1 dhe 2, Vendim nr. 175, datë 08.03.2017 “ Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar “ i ndryshuar, pikat 1 dhe 2, Ligjin nr. 69/2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “ I ndryshuar, neni 28, pika 1 dhe 2. Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Berat, Drejtorisë së Arsimit për vitin 2025” dhe PBA 2025-2027.

Po paraqesim per miratim numrin e kurseve dhe të instruktorëve të jashtëm në QKF Berat për vitin shkollor 2025-2026.

Kërkojmë nga ana juaj miratimin e numrit të kurseve dhe të instruktorëve të jashtëm ne QKF Berat për vitin shkollor 2025-2026, të propozuar nga drejtuesja e QKF Zj. Entela Toto.

Në bazë të Ligjit nr.69/2012, neni 15 “Qëndrat Kulturore të Fëmijëve janë institucione plotësuese, të cilat janë në varësi të njësive të qeverisjes vendore dhe hapen me vendim të Këshillit të Ministrave“.

Sipas Rregullores për funksionimin dhe veprimtarinë e Qëndrave Kulturore të Fëmijëve (QKF) **Neni 13**, “ Forma kryesore e punës në QKF është veprimtaria argëtuese e zbavitëse, shfrytëzimi i kohës së lirë në mënyrë të kulturuar dhe aktive, si dhe puna e programuar në kurset ku fëmijët ushtrohen për të zhvilluar dhuntitë e tyre”.

Neni 16, pika 1 “ QKF ndërtohen në bazë kursi dhe sektori”, **pika 2** “ Formimi i kurseve dhe sektorëve bëhet sipas kritereve të vendosura nga MASR, sipas kategorisë së QKF “, **pika 8** “ QKF-

4

të janë të kategorisë së dytë kur kanë 3 sektorë dhe sallën e shfaqjeve, me mbi 200 vende dhe në vendbanimin e tyre kanë **mbi 5 mijë nxënës. QKF e Bashkisë Berat është në kategorinë e dytë**

Sektorët e QKF-ve të kategorisë së dytë janë :

- a) **Sektori i artit**
- b) **Sektori i sportit**
- c) **Sektori shkencor**

Neni 17, pika 2 “ Për organizimin e punës në kurse vendosen instruktorë të cilët mund të jenë punonjës të jashtëm me profesione të ndryshme nga fusha e artit, sportit, shkencës, punonjës social të cilët janë kompetencë e vet institucionit të QKF-së “.

Neni 23, pika 2 “Veprimtaria në cdo kurs zgjat 90 minuta e barasvlershme me dy orë mësimi në shkollë. Kurset mbliidhen sipas veçorive të tyre jo më shumë se 3 herë në javë. Për kurse të veçanta dhe veprimtaritë masive fëmijët mund të mbliidhen jo më shumë se katër herë në javë”

Në bazë të Vendimit nr.175, dt 08.03.2017 “ Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar “, pika 6 “ Punonjësit e jashtëm, të specialiteteve të ndryshme, që japin mësim në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, në shkollat teknike e profesionale, **si dhe në kurset e ndryshme**, për cdo orë mësimore paguhen në të njëjtën masë me punonjësit mësimorë efektivë, sipas pikës 5 si më poshtë :

Në bazë të Vendimit nr.425, date 26.06.2024 “Per miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe institucionet plotesuese të sistemit arsmor parauniversitar, **pika 10**”

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj miratimin e **40 kurseve dhe 27 instruktorë të jashtëm** në QKF-ne Berat për vitin shkollor 2024-2025 , sipas tabelës më poshtë :

Sektoret	Nr	Kurset	Nr. grupeve	Nr.instruktoreve
Shkence	1	Anglisht	2	1
	2	Italisht	2	1
	3	Gjermanisht	1	1
	4	Matematike	4	2
	5	Fizike	2	1
	6	Kimi	2	1
	7	Informatike	2	1
Art	8	Pikturë	1	1
	9	Kor-solist	3	2
	10	Piano	2	1
	11	Violincel	1	1
	12	Violinë	1	1
	13	Perkusion	1	1
	14	Guida e qytetit tim	2	1
	15	Gazetari+ media virtuale	2	1
Sport	16	Futboll	1	1
	17	Volejbol	3	2
	18	Basketbol	2	2
	19	Tenis	1	1
	20	Ping-pong	3	2
	21	Arte marziale	1	1
	22	Shah	1	1
		Totali	40	27

Pagesa për këta instruktorë të jashtëm nuk kërkon ndryshime në buxhet për vitin 2025, pasi fondi është i parashikuar si “Shpenzime për honorare në programin buxhetor 9120”, Arsimi parashkollor dhe 9-vjekar , me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Berat, Drejtorisë së Arsimit për vitin 2025” dhe PBA 2025-2027.

DREJTOR
KLODIANA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

Berat, më: ____ . 10 .2025

RELACION

MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT “PROGRAMI RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 3 (RELOAD3)” SI DHE METODOLOGJISË PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat është përfituese e projektit ReLOAD3 - Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor III.

Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD). Ky program është vazhdim i nismës së mbështetur më parë - ReLOaD1 dhe ReLOaD2 të zbatuar në periudhën katër vjeçare 2017-2024.

Sikurse dhe në fazat e mëparshme të programit, objektivi specifik i programit është të forcojë bashkëpunimin midis bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Ballkanin Perëndimor, të kontribuojë në një mjedis më mbështetës për OSHC-të, bazuar në financime publike transparente, një kuadër ligjor mbështetës, si dhe rritje të angazhimit civil në hartimin e politikave, zbatim dhe monitorim.

Palët kanë identifikuar aktivitetet e mëposhtme në të cilat mund të zhvillojnë bashkëpunimin, me secilën Palë që vepron si subjekt në zbatim të mandatit, rregulloreve, politikave dhe procedurave të veta:

- i) Forcimin e bashkëpunimit midis bashkisë dhe organizatave të shoqërisë civile përmes zhvillimit të një modeli transparent dhe me bazë projekti i financimit të Organizatave të shoqërisë civile.
- ii) Forcimin e kapaciteteve të Bashkisë dhe OSHC-ve për dialog efektiv dhe zbatimin e skemave lokale të grantit;
- iii) Forcimin e shërbimeve të ofruara në përgjigje të nevojave të komunitetit vendor brenda Bashkisë Berat;
- iv) Kontributin në skemën e grantit bazuar në formularin e aplikimit dhe në letrën e interesit të Bashkisë Berat bashkëngjitur këtij memorandumit;
- v) Përgatitjen dhe zbatimin e (të paktën) një thirrje publike për projekte të OSHC-ve, të financuar plotësisht nga buxheti i bashkisë, brenda periudhës 2026-2028 duke përdorur metodologjinë LOD;
- vi) Shkëmbim direkt të njohurive midis qeverisjes vendore pjesëmarrëse, OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë në nivel rajonal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

Berat, më: ____ . 10 .2025

RELACION

MBI MIRATIMIN E MARREVESHJES SE GRANTIT TE PROJEKTIT “RiseUp-WB” DHE SHITESËS NE BUXHET

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat është përfituese e projektit “RiseUp-WB”, i financuar nga European Education and Culture Executive Agency (EACEA) në kuadër të programit Erasmus+ për ndërtimin e kapaciteteve. Projekti është një nismë 24-mujore që synon të fuqizojë organizatat e të rinjve dhe bashkitë në Shqipëri dhe Kosovë, veçanërisht ato që punojnë me të rinj të marginalizuar, përmes trajnimeve inovative, shkëmbimeve ndërkufitare dhe angazhimit në politikëbërje. Qëllimi kryesor është përmirësimi i punësimit të të rinjve, rritja e aftësive digjitale dhe inkurajimi i përfshirjes qytetare. Aktivitetet e projektit përfshijnë sesione “Training of Trainers” për zhvillimin e aftësive në punën rinore dhe menaxhimin e vullnetarëve, laboratorë aftësish digjitale dhe sipërmarrëse për mbi 50 të rinj, shkëmbime ndërkufitare në Spanjë dhe Itali, krijimin e Bordit Këshillimor Rinor, organizimin e tryezave mbi politikën rinore dhe fushatën “Zëri i të Rinjve”. Gjithashtu, projekti do të kulmojë me një konferencë përfundimtare në Estoni dhe përgatitjen e një plani qëndrueshmërie për bashkëpunimet e ardhshme.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti kërkohet miratimi i marrëveshjes së grantit të projektit “RiseUp-WB” **si dhe** shtesa në buxhetin e Bashkisë Berat në vlerën totale **4,533,348.2 lekë**, nga të cilat **3,626,698 lekë** janë të ardhura direkte për bashkinë dhe **906,669.7 lekë** përfaqësojnë bashkëfinancimin e bashkisë, i cili do të mbulohet me kosto staf. Projekti do të zgjasë **24 muaj**, deri në **shtator 2027**, dhe të ardhurat në buxhetin e bashkisë do të shpërndahen si më poshtë:

Kësti 1- 725,339.6 lekë për vitin 2025

Kësti 2- 725,339.6 lekë për vitin 2026

Kësti 3- 1,450,679.2 lekë për vitin 2027

Kësti 4- 725,339.6 lekë për vitin 2028

Duke pasur parasysh rëndësinë e projektit në forcimin e kapaciteteve institucionale, nxitjen e punësimit të të rinjve dhe përfshirjen sociale në nivel lokal e rajonal, propozohet miratimi i marrëveshjes së grantit dhe shtesës në buxhet për projektin “RiseUp-WB”.

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË
ERVIN CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

PËR MIRATIMIN E SHITESAVE NË BUXHET NGA PROJEKTI "HEVON IPA INTERREG SOUTH ADRIATIC"

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat është përfituese e projektit HEVON, Vaj Extra i Virgjër me Cilësi të Lartë dhe Rrjeti i Ndërmarrjeve të Vogla të Mesme Konkurruese, Interreg IPA South Adriatic".

Ky relacion paraqitet për miratimin e shtesës në buxhet në shumën 10,581,488.16 lekë për projektin "HEVON, Vaj Extra i Virgjër me Cilësi të Lartë dhe Rrjeti i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme Konkurruese, Interreg IPA South Adriatic", me kohëzgjatje 30 muaj, deri në Dhjetor 2027. Vlera totale e projektit për Bashkinë Berat është 12,577,995.36 lekë, nga të cilat 10,581,488.16 lekë janë financim i Bashkimit Evropian, ndërsa Bashkia Berat do të kontribuojë me 15% bashkëfinancim, në vlerën 1,996,507.20 lekë, që do të mbulohet me kosto stafi. Të ardhurat për projektin do të pasqyrohen në buxhetin e bashkisë sipas viteve përkatëse: për vitin 2026 në shumën 4,993,396 lekë dhe për vitin 2027 në shumën 5,588,092 lekë.

Projektit HEVON i janë parashikuar një sërë aktiviteteve që do të realizohen gjatë periudhës së zbatimit, si: tarifë fikse për udhëtim dhe akomodim, angazhimi i një asistenti projekti dhe financiar për monitorimin cilësor dhe financiar të zbatimit, zhvillimi i një fushate komunikimi mbi vajin e ullirit ekstra të virgjër me cilësi të lartë dhe praktikë më të mira në qarkun e Beratit, përgatitja e materialeve promovuese (banner, roll-up, fletëpalosje) dhe organizimi i udhëtimeve të bashkëpunimit ndërkufitar në Itali dhe Mal të Zi. Po ashtu, përfshihen ekspertë për përshtatjen e udhëzimeve dhe specifikimeve teknike për trajnime, printimi i materialeve trajnuese, organizimi i seminareve lokale dhe laboratorëve praktikë, zhvillimi i forumeve B2B me MSME nga Mali i Zi, përkthimi i materialeve, organizimi i konferencës përfundimtare, tryezave institucionale, si edhe prodhimi i videos përmbyllëse të projektit. Në kuadër të promovimit ndërkombëtar, parashikohet organizimi i "HEVON Point" në panairin SOL Verona, me degustim të vajit të ullirit dhe aktivitete promovuese, si edhe evente lokale në Berat me "HEVON Trolley".

Duke qenë se projekti sjell përfitime konkrete në zhvillimin ekonomik vendor, rritjen e cilësisë së produkteve lokale dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal, kërkohet miratimi i shtesës në buxhet në shumën 10,581,488.16 lekë për përfshirjen e tij në buxhetin e Bashkisë Berat për vitet 2026–2027 dhe për zbatimin e suksesshëm të projektit HEVON.

KRYETARI I BASHKISË
Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Berat, më 07.10.2025

Relacion

MBI MIRATIMIN E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT: "NDËRTIMI I RRUGËS SË RE BILÇË-DROBONIK, BASHKIA BERAT "

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit Nr. 8561, datë 25.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, VKM-së nr. 127 datë 23.03.2000 për "Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", Bashkia Berat ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik për pasuritë pronë private, për gjithsej 48 pronarë, të pronës të llojit "kullota" "toke are", "toke truall" "ullishte" dhe "ndertese" të ndodhura në Zonën Kadastrale 1217, për të cilat kerkohet miratimi juaj lidhur me vijimin e procedurave të shpronësimit për projektin " NDËRTIMI I RRUGËS SË RE BILÇË-DROBONIK, BASHKIA BERAT "

Projekti më sipër dhe miratimi në parim të procedurave të shpronësimit, është miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr.27 datë 17.04.2024.

Komisioni për procedurat e shpronësimit për interes publik, bazuar në dokumentacionin përkatës të projektit " NDËRTIMI I RRUGËS SË RE BILÇË-DROBONIK, BASHKIA BERAT " dhe këqyrjen në vend, thekson se prona private që preken nga realizimi i këtij projekti shtrihen në zonën kadastrale 1217.

Pasuria që preken nga investimi, me pronarë privatë, janë bashkëngjitur tabelës ku çmimet e shpronësimit përlllogariten dhe janë përcjellë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Në bazë të nenit 10 pika c) e ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, kërkohet si pjesë e dokumentacionit nga Agjencia Shqiptare e Shpronësimit, edhe miratimi nga Këshilli Bashkiak për shpronësimin e pronarëve që preken nga projekti "NDËRTIMI I RRUGËS SË RE BILÇË -DROBONIK ".Pronarët do të shpronësohen për pjesët e pronës që do të preken nga projekti, bazuar në çmimet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi, marrë me shkresë zyrtare nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Vlera totale e shpronësimit është: **16,181,340** lekë për pronat që shpronësohen për 48 pronare sipas tabelës bashkëngjitur.
Fondi për përballimin e kostos financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti Afatmesem 2026- 2028 i Bashkisë Berat.

Faleminderit

N/Kryetare e Bashkisë
Etleva DHIMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Berat, më 08.10.2025

RELACION

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË SHTËPIZAVE TË DRURIT PËR FESTAT E
FUNDVITIT PRANË SHESHIT "TEODOR MUZAKA"

Të nderuar këshilltarë !

Siç e dini tashmë Berati është kthyer në destinacion turistik dhe jo vetëm 3 apo 4 muaj në vit por gjatë gjithë vitit.

Berati nuk njeh më sezon, ka turizëm kombëtar dhe ndërkombëtar 12 muaj të vitit, kështu bashkia jonë është duke planifikuar për zhvillimin e eventeve të fundvitit 2025.

Edhe këtë vit bashkia po mendon zhvillimin e fesatve, në sheshin "Teodor Muzaka".

Duke parë dhe kapacitetet e sheshit, kemi menduar të vendosim kapacitet maksimal të shtëpizave të drurit në një numër prej 35 copë.

Do të bëhet aplikimi nga qytetarët e interesuar pranë zyrës sonë me një ndalesë, duke shprehur interesin e tyre për atë çka subjekti ofron për Festat e Fundvitit.

Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve do të bëjë përzgjedhjen e subjekteve mbi dorëzimin e dokumentacionit të tyre dhe do ja propozojë Kryetarit të Bashkisë.

Kriteret e posedimit të shtëpizave të drurit do të bëhen nga drejtoria juridike e cila do të jetë dhe drejtoria përgjegjëse për hartimin e marrëveshjes "Bashki-Subjekt".

Pasi të bëhet miratimi nga Kryetari i Bashkisë Berat, pas marrjes së një kopjeje të akt-marrëveshjes subjekti do t'i drejtohet Agjensisë së Shërbimeve Publike, për tu pajisur me faturën përkatëse dhe për të bërë pagesën në çdo bankë të nivelit të dytë.

Pas kësaj subjekti do të marrin në përdorim të tyre objektet (shtëpizat e drurit), të përcaktuara nga drejtoria e planifikimit urban dhe investimeve, marrja në përdorim e të cilave do të bëhet shoqëruar me anën e një proces-verbali me palë :

- Agjensia e Shërbimeve Publike si dorëzues i objektit të marrë me qera.
- Subjekti (Person fizik ose juridik i interesuar mbi ushtrim të aktivitetit).

Për sa më sipër Bashkia Berat kërkon :

1. Shfrytëzimin e 32 shtëpizave të drurit për një periudhë dy muaj dhe gjashtë ditë me tarifë 75,000.00 lekë/muaj.

2. Shfrytëzimin e maksimumit 3 shtëpizave të drurit për artizanet (sipas kërkesave) , me tarifë 20,000.00 lekë/muaj.

Për artizanët në raste se konstatohet në terren se shesin produkte jashtë fushës së tyre të veprimtarisë, në mënyrë të menjëhershme do të bëhet prishja e marrëveshjes.

3. Ky afat, do të fillojë me 01 Nëntor 2025 deri më 06 Janar 2026. Për të gjithë periudhën llogaritja do të jetë sipas formulës (Tarifa totale = (Tarifa mujore*nr e muajve) + (Tarifa mujore / 30 dite* 6).

4. Të miratojë një shtesë në planin e të ardhurave 2025 në vlerën 5,412,000.00 lekë, llogaria ekonomike 7109600 Të ardhura nga qeratë, të cilat i shtohen buxhetit të qendrës kulturore "Margarita Tutulani", fond ky që do të përdoret për financimin e eventeve të fundvitit 2025.

Duke ju falenderuar

Grupi i punës :

Kryetari i Bashkisë i Komanduar:

z. Ervin CECA

N/Kryetare e Bashkisë

Znj. Etleva DHIMA

Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave :

znj. Rovena SHEHU

Agjensia e Shërbimeve Publike :

znj. Joana MELENGU

Drejtorja e turizmit dhe aktiviteteve :

z. Marius ÇEPELE

Drejtorja Juridike :

z. Petro SINJARI

Drejtorja e Planifikimit urban, lejeve dhe investimeve

znj. Erida NASUFI

Drejtorja e taksave dhe tarifave

z. Daniel BENISHTA

Qendra kulturore "Margarita TUTULANI"

z. Arben QAFA



5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

**PËR NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 108 DATË
18.12.2024 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN
2025 DHE PBA 2025-2027 ”**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027”, VKB nr .86 datë 17.10.2024 “Mbi miratimin e zonave të parkimit me pagesë, tarifave të parkimeve publike: “Parkimi Goricë” dhe “Parkimi lindor i Goricës”, si edhe një shtesë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë Berat, për menaxhimin e tyre”, VKB nr. 98 dt. 11.12.2024 “Mbi miratimin e tarifave të të përdorimit me pagesë të fushave sportive “Parku Dua të luaj” dhe miratimin e përdorimit të ambienteve të parkut “Dua të luaj” pa pagesë sipas kategorive të caktuara”,

Ju paraqesim për miratim një projektvendim që lidhet me disa ndryshime të brendshme në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Berat, konkretisht për :

1. ndryshim në planin e të ardhurave vendore
2. rialokimin e fondeve midis programeve buxhetore dhe njësive shpenzuese

1. Ndryshim në planin e të ardhurave vendore

Në kuadër të rishikimit të buxhetit të vitit 2025, propozohet ndryshim në planin e të ardhurave vendore, shtimi në total me 2,950,000 lekë , si rrjedhojë e realizimeve dhe planifikimeve të reja gjatë kësaj periudhe.

Konkretisht :

- - 200,000 lekë pakësim në zërin “ Taksë vendore për zënien e hapësirave publike”, llog.ekonomike 7035002
. Në mbledhjen e këtij muaji është paraqitur projektvendimi për transferimin si kapital të tregut “Green Market” në përdorim të shoqërisë “Berat City Green” sha, e cila është në pronësi të bashkisë Berat. Sipas këtij projektvendimi administrimi i taksës së zënies së hapësirës publike për këtë treg do të kalojë nga Bashkia Berat tek Berat City Green sha. Në



B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

këtë kuadër, plani i të ardhurave vendore i bashkisë do të pakësohet në vlerën 200,000 lekë, që i korrespondon vlerës së llogaritur për t'u arkëtuar nga shfrytëzimi e kësaj hapësire për muajt nëntor-dhjetor 2025.

- + 2,800,000 lekë shtesë në zërin “ Të ardhura nga parkingu”, llog.ekonomike 7111007, si rezultat i të ardhurave të realizuara nga parkimi me pagesë në zonën e Goricës.
- + 350,000 lekë shtesë në zërin “ Të ardhura të tjera nga bileta”, llog.ekonomike 7114900, që burojnë nga shitja e biletave për frekuentimin fushave sportive të parkut “Dua të luaj”

Shtesa prej 2,950,000 lekë në planin e të ardhurave vendore reflektohet në anën e shpenzimeve, në pogramin për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike me destinacion financimin e punimeve për sinjalistikën rrugore horizontale në qytet.

Ky rishikim synon të garantojë përdorim efikas të të ardhurave vendore, duke i orientuar ato drejt ndërhyrjeve që rrisin sigurinë rrugore, orientimin e qarkullimit dhe cilësinë e infrastrukturës urbane.

2. Riallokimi i fondeve buxhetore

Këto ndryshime nuk sjellin rritje të totalit të buxhetit të miratuar, por konsistojnë në riallokime fondesh midis programeve buxhetore dhe njësive shpenzuese, me qëllim optimizimin e përdorimit të fondeve publike.

Riallokimet janë bërë në funksion të përmbushjes më efikase të nevojave reale të njësive përkatëse, si dhe për të garantuar zbatimin në kohë të projekteve dhe shërbimeve prioritare për komunitetin.

Këto lëvizje buxhetore janë rezultat i analizës së performancës buxhetore të deritanishme dhe pasqyrojnë një qasje dinamike dhe të përgjegjshme në menaxhimin financiar të bashkisë.

Pakësojmë fondet në disa zëra të shpenzimeve të programuara për arsye: të krijimit të fondeve të lira pas përfundimit të procedurave të prokurimit (tepicë midis vlerës së planifikuar dhe vlerës fituese nga prokurimi), nga vendet vakante në strukturë dhe shtojmë fondet në ato zëra shpenzimesh për të cilat ka dalë e nevojshme gjatë ushtrimit të funksioneve.

Riaolokimi i fondeve është kërkuar nga drejtuesit e njësive shpenzuese të bashkisë të cilët janë gjithashtu edhe drejtues të ekipeve të programeve buxhetore, si më poshtë :

2.1 Në njësinë shpenzuese Bashkia Berat propozojmë një rishpërndaje të fondeve në shumën 11,718,247 lekë, nga të cilat 5,768,247 lekë fonde të kursyera nga procedura e prokurimit të objektit “Rikonstruksion Qendra Rinore Lapardha”, dhe pjesa tjetër fonde të kursyera nga vendet vakante në strukturë.

Këto fonde propozohen të rishpërndahen për shpenzime personeli dhe operative, ku përmendim : 8,260,000 lekë për shpenzime personeli (paga& sigurime shoqërore e shëndetësore) për punonjësit e MZSH-së. Gjatë sezonit të verës së këtij viti struktura e MZSH-së është përballur me një numër të shtuar ndërhyrjesh për shuarjen e zjarreve në territorin e bashkisë, si edhe në bashkitë e tjera fqinje ose jo, e cila ka sjellë nevojën për pagesën e orëve të gatishmërisë, punës në turne të dyta e të treta, përtej nivelit të parashikuar fillimisht në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

buxhet. Përmendim se për gjithë vitin 2024 kosto për këtë qëllim ishte 4,915,508 lekë, ndërkohë vetëm për 3 muajt qershor-korrik-gusht 2025 janë paguar 5,869,282 lekë për orë gatishmërie dhe turne të dyta e të treta.

2.2 Në njësinë shpenzuese Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat propozojmë një rishpërndaje të fondeve në shumën 2,871,914 lekë.

- 661,200 lekë për kompensim të koston së transportit për 58 nxënës të shkollës së mesme të bashkuar “Koço Brisku” Lapardha, për 76 ditë mësimi në periudhën shtator-dhjetor 2025. Për shkak të rikonstruksionit të shkollës së mesme të bashkuar “Koço Brisku” Lapardha, nxënësit e kësaj shkolle po zhvillojnë mësimin në shkollën Otllak me 2 turne, si edhe në 2 ambiente me qera që Bashkia i ka siguruar për zhvillimin e procesit mësimor. Nxënësit e arsimit bazë dhe 18 nxënës të arsimit të mesëm do të kompesohen për transportin nga Ministria e Arsimit në bazë të ligjit për transportin e nxënësve të shkollave.

Janë 58 nxënës të arsimit të mesëm të cilët nuk nuk plotësojnë kriteret për te përfituar kompensimin e koston së transportit nga Ministria e Arsimit.

Në këto kushte kërkojmë që nga Bashkia Berat të kompensohen për koston e transportit të gjithë nxënësit që nuk plotësojnë kriteret për të përfituar kompensim nga Ministria e Arsimit, për transportin deri në përfundim të rikonstruksionit të shkollës “Koço Brisku” Lapardha .

Për vitin 2025 do të jetë i nevojshëm kompensimi i 58 nxënësve për 76 ditë ; konkretisht për 17 ditë në muajin shtator, 23 ditë në muajin tetor, 19 ditë në muajin nëntor dhe 17 ditë në muajin dhjetor,

Çmimi i biletës është i përcaktuar në ligjin për transportin e nxënësve, vajtje-ardhje në vlerën 150 lekë.

Fondi total i nevojshëm është 661,200 lekë.

- 2,210,714 lekë për blerje mjeti frigoriferik për ruajtjen dhe transportin e ushqimit të fëmijëve në kopshte, çerdhe dhe konvikt .

Mjeti ekzistues i transportit të ushqimit ka problematika të shumta, ndër më kryesoret janë: defektet e përsëritura të motorit të mjetit; dalja jashtë funksionit e termusit frigoriferik, i cili përbën rrezikshmëri si në qarkullim, ashtu edhe në ruajtjen e cilësisë së ushqimit. Mjeti do të vazhdojë të jetë në përdorim nga njësia shpenzuese Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat, për të plotësuar nevojat e shumta në shërbimin e transportit të mallrave në institucionet arsimore.

2.3 Në njësinë shpenzuese Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” do të bëhet saktësmi/ korrigjimi i kodit të programit buxhetor për aktivitetet social - kulturore miratuar në VKB nr. 58 datë 25.07.2025 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027 ” (rialokim fondesh)”

Kodi buxhetor korrigjohet nga AC102 “Arsimi & Kujdesi Social” në AF102 “Turizmi, Kultura dhe Sportet” . E bëjmë këtë korrigjim me qëllim përafrimin e saktë me klasifikimin përkatës buxhetor sipas strukturës së miratuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Për sa më sipër , rishpërndarja e shpenzimeve kërkohet sipas strukturave buxhetore të paraqitura në tabelat më poshtë .

Pakësime :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				11,718,247
2102001		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			4,800,000
2102001	1	AA102	V112AAB	600	Shpenzime per Paga	4,000,000
2102001	1	AA102	V112AAB	601	Shpenzime per Sigurime shoqerore	800,000
2102001		AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit			1,150,000
2102001	1	AE102	V614AAB	600	Shpenzime per Paga	1,000,000
2102001	1	AE102	V614AAB	601	Shpenzime per Sigurime shoqerore	150,000
2102001		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			5,768,247
2102001	5	AF102	P822AAZ	231	Rikonstruksion Qendra Rinore Lapardha	5,768,247
2102005		Drejtoria Arsimore Bashkia Berat				2,871,914
2102005		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			2,871,914
2102005	1.1	AC102	V912AAK	231	Hidroizolimi i shkolles 9-vjeçare "Zihni Toska"	1,416,837
2102005	1.1	AC102	V923AAI	231	Hidroizolimi i tarraces se Konviktit "Kristo Isak" dhe i rrjetit te hidrosanitareve	26,717
2102005	5	AC102	P912ABZ	231	Punime ne permiresimin e infrastruktures ne arsimin baze, Shkolla Paftal, Njesia Administrative Sinje	767,160
2102005	1	AC102	V923AAB	602	Blerje materiale pastrimi	304,200
2102005	1	AC102	V923AAB	602	Blerje materiale te tjera	357,000
2102006		Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"				10,000,000
		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			10,000,000
2102006	5	AC102	V823AAC	602	Veprimtarisë kulturore dhe artistike	10,000,000
Total Pakesime						24,590,161

Shtesa:

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				11,718,247
2102001		AA102	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse			2,308,247
2102001	5	AA102	V111AAD	602	Shpenzime Operative	2,308,247
2102001		AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit			8,260,000
2102001	1	AE102	V328AAB	600	Shpenzime per Paga	3,556,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2102001	5	AE102	V328AAB			3,460,000
2102001	1	AE102	V328AAB	601	Shpenzime per Sigurime shoqerore	1,244,000
2102001		AC102	Arsimi dhe Kujdesi Social			1,150,000
2102001	1	AC102	V014AAA	600	Shpenzime per Paga	1,000,000
2102001	1	AC102	V014AAA	601	Shpenzime per Sigurime shoqerore	150,000
2102005	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat					2,871,914
2102005		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			2,871,914
2102005	1.1	AC102	P912AAS	231	Blerje mjeti frigoriferik për ruajtjen dhe transportin e ushqimit të fëmijëve në kopshte, çerdhe dhe konvikt	1,443,554
2102005	5	AC102	P912AAS	231		767,160
2102005	1	AC102	V923AAB	602	Sherbime nga te trete (pagese transport nxenes)	661,200
2102006	Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"					10,000,000
2102006		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			10,000,000
2102006	5	AF102	V823AAC	602	Veprimtari kulturore dhe artistike	10,000,000
Total Shtesa						24,590,161

Ju faleminderit ,

Arisa TOSKA
Sekretar i Përgjithshëm

Bledar ÇILI
N/Kryetar i Bashkisë
Drejtore i NJ.SH. Drejtoria e Bujqësisë

Rovena SHEHU
Drejtore i Financës dhe Buxhetit

Petro SINJARI
Drejtore i Drejtorisë Juridike

Ervin QECA
Kryetar i Bashkisë

Etleva DHIMA
N/Kryetar i Bashkisë



10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Artan MERKO
Drejtore i MZSH

Daniel BENISHTA
Drejtore i Komanduar Taksave dhe Tarifave Vendore

Klodiana HOXHA
Drejtore i NJ.SH. Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat

Joana MELËNGU
Drejtore i NJ.SH. Agjencia e Shërbimeve Publike

Arben QAFA
Drejtore i NJ.SH, Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2026-2028, FAZA e RISHIKUAR

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të ligjit Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndyshuar , Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore ” i ndryshuar , Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 28.02.2025 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”, Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e PBA Vendor 2026-2028”, VKB nr.39, datë 30.04.2025 “ Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2026-2028”, VKB nr.59, datë 29.07.2025 “ Për miratimin e tavaneve përfundimtare të PBA 2026-2028”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Bashkia Berat ka përgatitur dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028, faza e rishikuar. Dokumenti i rishikuar në këtë fazë të dytë është ndërtuar mbi tavanet buxhetore të miratuara si edhe duke marrë parasysh rekomandimet e dërguara nga Ministria e Financave me shkresë të datës 18.06.2025 “ Dërgohen mendime mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028” .

Komentet dhe sugjerimet prekin :

1. Të ardhurat vendore

Rekomandimi i Ministrisë për rritjen e parashikimit të të ardhurave vendore nuk është reflektuar në këtë fazë, pasi Bashkia Berat nuk parashikon ndryshime në paketën fiskale vendore.

Parashikimet e të ardhurave janë mbajtur në nivele realiste, duke u bazuar në performancën faktike të viteve të fundit, në mënyrë që të shmanget mbivlerësimi dhe mosrealizimi gjatë ekzekutimit të buxhetit.

Megjithatë, administrata bashkiake po punon për të rritur efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave përmes përmirësimit të administrimit tatimor lokal, dixhitalizimit të shërbimeve dhe luftës kundër informalitetit. Këto masa pritet të sjellin rritje graduale të të ardhurave vendore edhe pa ndryshuar nivelin e tarifave dhe taksave.

2. Shpenzimet për personelin

Ministria ka rekomanduar uljen e peshës së shpenzimeve të personelit, të cilat zënë mbi 50% të buxhetit total. Ky rekomandim nuk është zbatuar, pasi Bashkia Berat nuk mund të reduktojë pagat apo numrin e punonjësve, duke qenë se:



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

- Shërbimet publike bazë (arsim, çerdhe, kopshte, shërbime sociale, pastrimi dhe gjelbërimi, administrimi i njësive administrative) kërkojnë staf të qëndrueshëm.
- Reduktimi i personelit do të sillte ulje të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe rrezikim të përmbushjes së detyrimeve ligjore të bashkisë.
- Pagat e punonjësve janë të përcaktuara me vendime të Këshillit të Ministrave dhe çdo ndërhyrje në uljen e tyre do të ishte në kundërshtim me kuadrin ligjor kombëtar.

3. Shpenzimet kapitale

Në këtë fazë nuk është bërë rritje e shpenzimeve kapitale. Megjithatë, po vijon puna për detajimin e projekteve të vitit 2026, të cilat do të pasqyrohen në draftin përfundimtar të PBA-së dhe në projekt-buxhetin vjetor. Objektivi mbetet rritja graduale e investimeve në infrastrukturë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

4. Rishikimi i produkteve

Bashkia Berat ka kryer rishikimin e disa produkteve, sasive dhe kostove, duke përshtatur shpenzimet në përputhje me analizën e nevojave dhe prioritetet vendore, sipas rekomandimit të Ministrisë së Financave.

Procesi i konsultimeve publike

Në përgatitjen e këtij dokumenti janë zhvilluar dëgjesa publike në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Berat, për të garantuar përfaqësimin e komuniteteve si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Gjithashtu, janë organizuar takime të posaçme me grupe interesi si bizneset, organizatat e shoqërisë civile, mësuesit, stafi shëndetësor, të rinjtë dhe pensionistët, për të mbledhur mendime dhe sugjerime mbi prioritetet buxhetore.

Procesi i dëgjësave është zhvilluar me transparencë të plotë, i dokumentuar me procesverbale, dhe sugjerimet e qytetarëve janë marrë në konsideratë në hartimin e këtij dokumenti. Kjo siguron që PBA 2026–2028 të mos jetë vetëm një planifikim administrativ, por edhe një produkt i përbashkët i qytetarëve dhe bashkisë.

Ju faleminderit ,

Ervin ÇECA
Kryetar i Bashkisë